

BASHKIA TEPELENE

Njoftim per dhenien me qira

Ne zbatim te Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.433, datë 08.06.2016 për “Transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave te inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”; Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.01, datë 09.06.2016 për “Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”; certifikatave te pronesisë te pasurive me nr 416/12 dhe 418; VKB nr 33 date 28.09.2017 “Per shprehjen e pëlqimit në parim për dhënien me qira të pasurisë me nr.416/12 dhe 418.të llojit “pyll” ndodhur në njësinë Administrative, Qender ”

NJOFTOJ:

Fillimin e procedurave te dhenies me qira me ane te konkurrimit te siperfaqes me perberje shkurre , ngasra pyjore me nr 1 ne ekonomine pyjore Dukaj-Luzat, me siperfaqe 0.8 ha dhe 2.54 ha, te ndodhur ne ZK 2541 ",Njesia Administrative Qender/ Bashkia Tepelene, prone e Bashkise Tepelene

II. Qellimi i perdorimit do te jete per qellime pushimi argetimi, shendetsore e shoqerore dhe veprimtari turistike kampingje.

III. Cmimi dysheme do te jete ne zbatim te VKM nr 1064 date 22.12.2010 “Per disa ndryshime ne VKM nr 391/2006 “Per caktimin e tarifava ne sektorin e pyjeve dhe te kullotave”, duke filluar nga 303.000 (treqind e tre mije) leke

IV. Afati i kontrates se qerese eshte deri ne10 vjet.

V. Vleresimi i konkurrenteve do te behet sipas ketyre pikave:

Projekti teknik I veprimtarise qe do te ushtrohet I cili permban hartën topografike me kordinatet e siperfaqes object perdorimi ne variantin pdf dhe format elektronik ne shkalle 1:10000 ku jane evidentuar elemente kryesore ,si :kufijtenatyrore, relieve, objketet aktuale, si dhe cdo planimetri tjetër ne shkalle me te detajuar , hartuar conform kerkesave 20 pike

Plani I biznesit dhe investimet 15 pike

Niveli I punesimit 5 pike

Masa e qirase per ha/vit 35 pike

VI. Terheqja e dokumentacionit te nevojshem do te behet ne Drejtorine Ligjore te Bashkise Tepelene.

VII. Paraqitja e dokumentacionit do te behet ne date me date 26.10.2017, ora 9 00 ne zyren e protokollit te Bashkise Tepelene dhe konkurimi do te vijoje ne sallën e mbledhjeve .

VIII. Dokumentacioni qe duhet te plotesohet nga konkurrentet per konkurrim eshte:

- a) kerkesen e se bashku me te dhenat per gjeneralitetet e tyre
- b) ekstrakti e regjistrimit ne QKB per objektin e veprimtarise
- c) projektin teknik te hartuar nga specialist te licensuar ku jane trajtuar te gjithë elementet e nevojshem per zhvillimin e veprimtarise se kerkuar.
- ç) planbiznesin e hollesishem, ku te pershkruhen qarte: plani i punesimit, plani i investimeve, si dhe treguesit qe do te realizohen.
- d) te dhena per kapacitetete teknike, stafin, makineri qe zoteron
- e) planin e reabilitimit te siperfaqes dhe kthimin e saj ne gjendje te mepershme
- f) oferte e detyrimit mujor te qirase
- g) Certifikaten e regjistrimit dhe ekstraktin historik te regjistrimit ne QKR te subjektit.
- h) NUIS-in dhe vertetimin nga dega e tatimeve se subjekti nuk ka detyrime tatimore.
- i) Vertetim nga institucionet perkatese se nuk eshte ne ndjekje penale dhe nuk ka proces gjyqesor qe lidhet me veprimtarine qe ushtron.
- j) leje mjedisore per aktivitetin e kerkuar.
- k) garanci te mjaftueshme per perballimin e investimit te parashikur ne plan biznesin e dorezuar (vetetim nga banka).

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.